



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. _____ Prot.

Koplik, më _____, 2020

V E N D I M

Nr 80 datë 27 / 11 / 2020

Për ndryshim në Vendimin nr.65, datë, 30.10.2020 të Keshillit Bashkiak Malësi e Madhe : “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së shtetasit z.Tonin Lelçaj.

Baza ligjore

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 27.11.2020,

Si dhe rregullorja e Keshillit Bashkiak Malesi e Madhe Nr.17 datë 30.04.2020 Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe

Në mbështetje të nenit 19,29 si dhe të nenit 54 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Në mbështetje të Ligjit nr.45/2019 datë, 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” .

Në mbështetje të Kreu III pika 1, gërma “ dh” si dhe të Kreu III pika 2, gërma “ ç” të VKM nr.329 datë 16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” .

Në mbështetje të Udhëzimit të përbashkët nr.263 datë 24/5/2013 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare përmbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” Kreu III – të.

Si dhe në mbështetje të shkresës nr.608/1 prot, datë ,25.08,2020 të Prefektit të Qarkut Shkoder, protokolluar me tonën nr.1971/10 prot., datë, 31.08.2020, propozojmë /relatojmë miratimin e VKB

nr.47, datë, 30.07.2020, sipas relacionit me ndryshimet/korigjimet përkatëse konstatuar gjatë shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur vendimit,

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e Vendimit nr.65 datë ,30.10.2020 të Keshillit të Bashkisë Malësi e Madhe ‘’ Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të shtetasit z.Tonin Lelçaj ,Për dhënien e ndihmës së menjëherëshme financiare nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Malesi e Madhe në mbështetje të VKB nr 6 date 18.01.2020 për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 si dhe sipas shkresë së MFE me nr 23198 prot datë 24.12.2019, familjes së shtetasit z.Tonin Lelçaj, të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore,



2. Kërkesa, mbështetur në dokumentacionin tekniko-ligjor me ndryshimet perkatëse sipas shkreses nr 777/1 prot datë 16.11.2020, protokollua me tonen 3004/12 date 20.11.2020, bëhën korrigjimet simas poshtë vijon.
Referuar pikes së parë të kesaj shkresë si dhe dekomentavë shoqeruese përcaktohet qartësisht që është djegur vetem kuzhina së bashku me orendite.
3. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit **Tonin Lelçaj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe t'i propozojë/kërkojë mbështetje Agjencise Kombetare të Mbrojtjes Civile (AKMC), në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën financiare, për shkak të mungesës së fondeve nga ana e Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 27.11.2020

Vota Pro 17

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 04.12.2020

